



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 8121 Prot

Shkodër, më 14.05.2019

URDHËR

Nr. 389 datë 14.05.2019

“PËR KRIJIMIN E GRUPIT TË PUNËS PËR HARTIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020” si dhe në lidhje me zbatimin e masave të veçanta të parashikuara në Planin e Veprimit 2018-2020 të miratuar me VKM-në nr.241, datë 20.04.2018 Për Zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit”;

Urdhëroj :

1. Ngritjen e grupit të punës për hartimin e Planit të Integritetit për Bashkinë Shkodër,
 2. Caktimin e Z.Pëllumb Zogu, me detyrë Përgjegjës pranë Njesisë së Auditit, si koodinator të grupit të punës përgjegjës për hartimin e planit të integritetit në Bashkinë Shkodër.
- 2.1 Pjesë të grupit të punës përgjegjës për hartimin e planit të integritetit janë ;

1. Drejtoria e Financës
2. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse
3. Drejtoria e Analizës dhe e Programimit Buxhetor
4. Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve
5. Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit
6. Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës
7. Drejtoria Juridike, Menaxhimit të aseteve dhe Aksioneve të Ndërmarrjeve
8. Prokurimet
9. Drejtoria e të Ardhurave
10. Gjergj Kurti-Koordinatori i të drejtës për informim
11. Fisnik Lutfija- Koodinatori për njoftimin dhe konsultimin publik

3. Grupi i punës, brenda 30 ditëve, harton një program pune për zhvillimin e planit të integritetit për Bashkinë.

4. Grupi i punës është i detyruar të hartojë një plan për integritetin e institucionit, në mbështetje të Metodogjisë së Vlerësimit të Rriskut të Integritetit për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, dhe t'ia dorëzojë Titullarit, brenda 3 (tre) muajve nga data e miratimit të këtij urdhëri.
5. Drejtoritë ngarkohen për analizimin, vlerësimin, trajtimin, monitorimin dhe komunikimin e risqeve kryesore të integritetit që shoqërojnë veprimtarinë e punës sipas profilit të punës së secilit.
6. Të gjitha strukturat e brendshme të Bashkisë duhet të angazhohen për mbështetjen e grupit të punës, në dhënien e informacioneve të nevojshme, në identifikimin e rrisqeve, vlerësimin, dhe rishikimin e masave ekzistuese për adresimin e tyre.
7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjitha drejtoritë, pjesë e këtij urdhëri, si dhe të gjitha strukturat e Bashkisë.
8. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

